



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 644-50014/2019

Klinë, me 16.12.2019

Duke u bazuar ne nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, publikuar ne Gazetën Zyrtare me 04.06.2008, nr.28/2010, nenin 91 të Statutit të Komunës së Klinës, nr.01-110-1232/2010 të dt.07.04.2010, si dhe duke marrë parasysh prishjen e rendit dhe qetësisë publike në prag të festave të fundvitit, kryetari i Komunës së Klinës, më dt.16.12.2019, merr këtë:

V E N D I M

Për

Ndalimin e përdorimit dhe shitjes së paautorizuar të mjeteve piroteknike

- 1. NDALOHET**, ndezja dhe përdorimi i fishekzjarrëve dhe mjeteve piroteknike në hapësirat publike, përkatësisht tregje, rruge, sheshe dhe zona të banuara, si dhe shitja e tyre nga persona dhe vende të paautorizuara.
- 2.** Përjashtim nga ndalesa, behet më datën 24.12.2019 nga ora 19:00 deri ne orën 00:00, si dhe datën 31.12.2019 nga ora 23:00 deri 00:30 të datës 01.01.2020, më kusht që përdorimi i tyre të behet në mënyrë të organizuar dhe kontrolluar.
- 3.** Ndaj personave të cilët veprojnë në kundërshtim më këtë ndalesë, shqiptohet gjoja në shumën prej **100 €** (njëqind euro), si dhe do të ndërmerren masat tjera sanksionuese në përputhje më dispozitat e Ligjit për Përdorim Civil të Eksploziveve, nr.04/L-022 si dhe Ligjit për Kundërvajtjet, nr.05/L-087, si dhe aktet tjera nënligjore.
- 4. OBLIGOHET**, Drejtoria e Inspektoratit, që në bashkëpunim më Policinë e Kosovës-Stacioni Policor në Klinë, të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme ndaj shkelësve eventual të kësaj ndalesë.
- 5.** Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi më rastin e nënshkrimit te tij nga Kryetari i Komunës dhe fillon së zbatuari nga data 16.12.2019.

Te njoftohen:

- Drejtoria e Inspektoratit;
- Stacioni Policor në Klinë;
- kopje ne tabelën e shpalljeve
- Ekzekutivi, si dhe;
- Arkivi.



Kryetari,
Zenun Elezaj